

GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR- Ismail Kadare

LEKSIKOLOGJI

Emrat e përveçëm

Emrat e përveçëm janë emra të veçantë të sendeve, vendeve ose njerëzve. Shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe. Emrat e përveçëm nuk janë përdorur me ndonjë ngjyrim të caktuar nga autori. Një pjesë e tyre janë emra të marrë prej fakteve historike ose të krijuara rishtazi.

1. Nicë (plakë vendase e vjetër)
2. Koloneli Z (Zampa)
3. Beti (e fejuara e një oficeri)

Toponimet

Tërësia e emrave të vendeve. Emrat e vendeve janë reale e jo të krijuara prej autorit.

1. Tiranë
2. Mali i Dajtit

Fjalët e huaja

Fjalë të huazuara prej gjuhëve të tjera. Në vepër, megjithëse gjenerali dhe prifti nuk janë shqiptarë, fjalët e huaja janë të pakta (karakteristikë e stilit të Kadaresë)

1. Tendë
2. Tragjedi
3. Gjeneral
4. Oficer
5. Trille
6. Kolonel
7. Klubi

Fjalët e vjetra

Fjalët e vjetra janë fjalë që përdorshin më përpara dhe që nuk fliten në gjuhën standarte. Meqë ngjarjet në libër janë zhvilluar kohë më parë e në fshatra thuajse të prapambetur, fjalë të tilla janë përdorur pa kursim. Më tepër këto lloj fjalësh janë vendosur në gojën e vendasve , sepse gjenerali nuk fliste shqip.

1. Qyqe
2. Cartur
3. Kuja
4. Gjer
5. Kthina
6. Kësi

7. Lodra
8. U ngrys
9. Thiravaja
10. Vaji
11. Guna

LESIKU

Sinonime

Quhen fjalët me kuptim të njëjtë.

1. Sqaroj - shpjegoj
2. Pa - vështroi
3. Ngrihem - çohem
4. Mos tërheqim vëmendjen - mos biem në sy

Antonime

Quhen fjalët me kuptim të kundërt.

1. ngrihen - ulen
2. i papërqëndruar - i përqëndruar
3. u afruan - u larguan
4. të gjithë - asnjëri

Homonime

Homonimet janë fjalë të ndryshme, që kanë përbërje tingëllore të njëjtë e kuptime të ndryshme. Në vepër gjenden disa të tilla.

- vera - si një prej katër stinëve të vitit
- vera - si pije
- pa - e përdorur si pjesëz mohuese
- pa - e përdorur si folje (vështroi)

Shprehjet frazeologjike

Autori ka përdorur shprehje të tilla për ta bërë vepren tërheqëse dhe të pasur nga ana letrare.

1. Fjala i mbeti në buzë - ngriu
2. Pa i zotëruar dot gjunjët - dridhej
3. U njollosoi emri - u turpërua

MORFOLOGJI

Emri

Emri është klasë e ndryshueshme fjalësh, që emërton dukuri, frymorë, objekte. Autori e ka përdorur emrin më shumë se çdo klasë tjetër fjalësh. Emrat e përdorur në shumicën e rasteve janë të numrit njëjës dhe gjinisë mashkullore.

- Ushtar - emër, gjiniya mashkullore, rasa emërore, numri njëjës, trajta e pashquar, lakimi i parë
- Gjenerali - emër, gjiniya mashkullore, rasa emërore, numri njëjës, trajta e shquar, lakimi i parë
- Dorën - emër, gjinia femërore, rasa kallzore, numri njëjës, trajta e shquar, lakimi i tretë
- E thesit - emër, gjiniya mashkullore, rasa gjinore, numri njëjës, trajta e shquar, lakimi i parë

Mbiemri

Klasë e ndryshueshme fjalësh, që shpreh cilësi të frymorëve e të sendeve. Autori i ka përdorur mbiemrat në më të shumtën e rasteve si epitete. Disa prej mbiemrave të përdorur janë: i/e madh/e, i fortë, e lehtë, i gjatë, e pamundur, e zeza etj.

- e madhe - mbiemër, gjinia femërore, rasa kallzore, numri njëjës
- i fortë - mbiemër, gjinia mashkullore, rasa emërore, numri njëjës
- e qartë - mbiemër, gjinia femërore, rasa kallzore, numri njëjës

Përemri

Është klasë e ndryshueshme që tregon në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar: frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara. Përemri është përdorur nga autori edhe në formën e trajtës së shkurtër, p.sh: *më, i, të, t'i*, etj.

- ai - përemër vetor, veta e tretë, numri njëjës
- të gjithë - përemër i pacaktuar
- e imja - përemër pronor, veta e parë, numri njëjës
- askush - përemër i pacaktuar

Folja

Folja është klasë e ndryshueshme fjalësh, që tregon veprim a gjendje. Foljet që ka përdorur autori janë kryesisht në kohë të ndryshme, që i përkasin së shkuarës dhe në kohën e tashme.

- arriti - folje, veta e tretë, numri njëjës, zgjedhimi i parë, koha e kryer e thjeshtë

- është - folje, veta e tretë, numri njëjës, zgjedhimi i katërt, koha e tashme

SINTAKSË

Fjalja

Fjalja është njësi e plotë ndërtimore, kuptimore e intonative e formuar nga bashkimi i fjalëve dhe i grupeve të fjalëve sipas rregullave të gjuhës. Llojet e fjalisë të përdorura nga autori janë të larmishme, por më të shpeshta janë fjalitë dëftore dhe pyetëse.

- E kishte varrosur tek pragu.
- Gjenerali nuk i hiqte sytë nga thesi.
- Ke frikë?
- Çfarë tha ajo plakë?

Llojet e fjalisë sipas ndërtimit

Kadare ka përdorur fjali të të gjitha llojeve (të thjeshta, të përbëra me bashkërenditje, të përbëra me nënrenditje dhe të miksuara), por më tepër gjenden fjali bashkërenditëse shtuese dhe kundërshtuese.

P.sh: Deshi të thoshte diçka të rëndë, por nisi dhe lodra dhe ai nuk foli.

Kryefjala

Kryefjala është fjala ose grupi i fjalëve, me të cilin përshtatet folja në numër dhe vetë. Kryefjala është e shprehur me grup emëror më të shumtën e rasteve: emër + përcaktor. P.sh:

1. Emri i ushtrisë sonë
2. Gjenerali i përhumbur
3. Nica e shkretë
4. Gratë e tmeruara
5. Thesi i vjetër i arnuar

Kallëzuesi

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë, që qëndron zakonisht pas kryefjalës. Kallëzuesi është përdorur nga autori, i shprehur si me kohë foljesh të thjeshta, ashtu edhe me kohë foljesh të përbëra. Autori ka përdorur, gjithashtu edhe kallëzues emërorë. P.sh:

- ishte e shushatur (kallëzues emëror)
- kishte lëvizur (kallëzues i përbërë)
- qe vendosur (kallëzues i përbërë)
- tregoi (kallëzues i thjeshtë)

- ishte e qartë (kallëzues emëror)

Përcaktori

Përcaktorët janë fjalë, që saktësojnë, sqarojnë, përcaktojnë emrin bërthamë. Përcaktori është përdorur nga autori i shprehur kryesisht me mbiemër. Brenda grupit të kryefjalës, ai ka përdorur, gjithashtu edhe përcaktorë kallëzuesorë. P.sh:

- plaka e shushatur
- gjahtari i vjetër
- u hodhën të lemetitura (përcaktor kallëzuesor)

Rrethanori

Rrethanori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që tregon rrethanat e kryerjes së veprimit. Autori i ka përdorur të gjitha llojet e rrethanorëve, por më tepër rrethanorin e vendit, për të treguar vendndodhjen e fshatrave, varreve, shtëpive etj.

- përreth
- lart në male
- atje lart
- në park
- në shesh

FIGURAT LETRARE

Epitetet janë mbiemra të përdorura me kuptim jo të drejtpërdrejtë.

- pyll i ngrysur
- guxim i cartur
- fytyrë e vdekur
- zë i trembur

Krahasimi quhet edhe figurë elementare, forma e parë e njohjes, pasi një send ose një dukuri na e jep duke e krahasuar me një send ose dukuri tjetër.

- si një koriye shumëngjyrëshe
- si kori i një tragjedije
- si gjahtar i vjetër
- si një e vdekur
- si dy të dehur

Metafora është cilësuar si një krahasim i shkurtuar. Pra tregon një objekt, që ka me të parin një raport ngjashmërie.

- fluturonte shqetësimi
- sytë i nguleshin
- gërneta ngrihej
- gërneta ngashërehej

FJALËFORMIMI

TË PARME	TË PREJARDHURA	TË PËRBËRA
GRI	I SHOQËRUAR	SHUMËNGJYRËSH
GUXOJ	PËRGJIGJE	FJALËSHUMË
SHTËPIJA	E HARRUAR	RRUGËZGJIDHJE
IK	DIMËROR	SIPËRFAQE
TRUP	MBRËMJE	HAKMARRËS
LARG	SHIKIME	MESNATË
ECTE	HESHTJE	AUTOMOBILISTIKE
PRIFT	GJYKIM	
PO	VËSHTRIM	
JEP	I DEHUR	
FLAS	FILLIM	
TRYEZË	PËRKTHEMANI	
PUS	VARROSUR	
ULEN	E NDOTUR	
DOLLI	PËRPARA	
SONTE	GROPOS	
BININ	ERRËSIRË	
NGRIJ		
MUZIKË		
NDJENTE		